

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti për Krime të Rënda- në përbërje Gjyqtari Gëzim Pozhegu dhe me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. G., L. G. dhe L. G. që të tre nga fshati J., Komuna e Gjakovës, me çka si bashkëkryes kanë kryer veprën penale: shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i akuzuari L. G., për veprën penale : mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktakuzë PP/I.nr.134/13, të datës 23.08.2016, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur në prezencën e prokurorit të shtetit Ali Ukës, të akuzuarve A. G., L. G., L. G. dhe mbrojtësit të tij av. N. Th. nga Prishtina, si dhe të dëmtuarve M. K. dhe P. K., me datën 30.01.2017, publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

1. A. G., i biri i K. dhe nenës D., e gjinisë K., i lindur me ... në fshatin J., K. e Gjakovës, ku dhe tani banon, me nr. Personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 10.07.2013 deri më 29.08.2013, kinse i padënuar më parë.

2. L. G. i biri i A. dhe nenës T., e gjinisë K., i lindur me... në Gj., me banim në fshatin J., K. e Gjakovës, me nr. personal..., ka të kryer shkollën e mesme-fizoterapisë, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 10.07.2013 deri më 29.08.2013, ndërsa deri me dt. 27.02.2014 ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak, kinse i padënuar më parë.

3. L. G., i biri i A. dhe nenës T., e gjinisë K., i lindur me ... në Gj., me banim në fshatin J., K. e Gjakovës, me nr. personal..., ka të kryer Fakultetin juridik, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 10.07.2013 deri më 04.10.2013, kinse i padënuar më parë.

JANË FAJTOR

I.

Se me datë 01.07.2013 rreth orës 20:00 minuta, në një rrugë të fshatit J., Komuna e Gjakovës me armë zjarri dhe mjete të rrezikshme, tërfurk dhe shkopinjtë druri kanë shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurisë së tyre, në atë mënyrë, që të pandehurit A., L. dhe L. G. pasi më parë i vërejnë të dëmtuarit duke kaluar me traktor pranë shtëpisë së të pandehurve, ju zënë pritën të dëmtuarve M. dhe P. K., dhe me atë rast të dëmtuarit menjëherë zbresin nga traktori dhe aty fillon një rrahje në mes të pandehurve dhe të dëmtuarve ku të pandehurit përdorin tërfurk dhe shkopinjtë druri ashtu që me të vërejtur rrezikun që iu kanosej të dëmtuarit me traktor me të shpejtë largohen nga vendi i ngjarjes në drejtim të shtëpisë së tyre dhe me këtë rast të pandehurit ju vien pas ashtu që i pandehuri L. fillon të shtënë me pushkë automatike AK-47, dhe nga ato të shtëna të dëmtuarit pësojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshëm për shëndetin të konstatuara nga ekspertiza mjeko-ligjore përkatësisht eksperti mjeko- ligjor Dr.N. U., e po ashtu nga predhat goditet edhe traktori si dhe që të katër gommat dhe më pas që të tre të pandehurit në të shpejtë largohen nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur, ashtu që të dëmtuarit menjëherë dërgohen për në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, për ofrimin e ndihmës mjekësore ndërsa të pandehurit arrestohen menjëherë nga ana e policisë.

- **Me çka si bashkë kryes kanë kryer veprën penale : shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

II. I akuzuari L. G.

Se:

Më parë ka siguruar dhe gjer me datën 10.07.2013 pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë një pushkë automatike AK-47, kalibër 7.65 mm, të cilën armë ditën kritike rreth orës 20:00/h, e ka përdorur në mënyrë përshkruar si në dispozitivin e I-rë të kësaj aktakuze duke shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e të dëmtuarve M. dhe P. K., si dhe duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, të cilën armë e konfiskojnë policia të njëjtën ditë në shtëpinë e të akuzuarit në fshatin J., K. e Gjakovës.

- **Me çka ka kryer veprën penale : Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 6,17 al. 1,41,43, al. 3, 46,73 e 83, nenin 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nenin 374 par.1 dhe 3 të KPRK-së, si dhe neneve 359, nenit 365 par. 1 366, 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 463 të KPRK-së të akuzuarit i,

GJYKON

I. Të akuzuarin A. G., me

ME DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ NJË (1) VITI, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 10.07.2013 deri më 29.08.2013

Kështu që në bazë të nenit 51 par. 1, 2 dhe 3 të KPRK-së, i shqiptohet,

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, që i' u është shqiptuar të akuzuarit A. G., nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari A. G., në afat prej 3 (tre) viteve, nuk do të kryejë vepër të re penale.

II. Të akuzuarin L. G. për veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së e :

GJYKON

ME DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ SHTATË (7) MUAJSH, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në ka paraburgim nga data 10.07.2013 deri më 29.08.2013, ndërsa deri me dt. 27.02.2014 ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak

Për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, gjykata e

GJYKON

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ NJËMIJEPESËQIND (1.500,00)EURO

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet brenda afatit të paraparë atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej 75 (shtatëdhjetepesë) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga 20 €, (njëzet euro).

Në kuptim të nenit 374 par. 3 të KPRK-së, të konfiskohet një pushkë automatike AK-47, kalibër 7.65 mm si objekt i kryerjes së veprave penale.

III. Të akuzuarin L. G. e :

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ GJASHTË (6) MUAJ, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 10.07.2013 deri më 04.10.2013

Gjykata në bazë të kërkesës së të dënuarit dënimin me burgim ia zëvendëson në dënim me gjobë :

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 gjashtë muajsh të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej dymijepesëqind (2.500,00)Euro.

Në kuptim të nenit 450 par.1 të KPK-së, të akuzuarit në mënyrë solidare obligohen të paguajnë shpenzimet procedurale penale në shumë prej 50 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 euro, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, palët e dëmtuara udhëzohen që kërkesën pasurore juridike të realizojnë në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktakuzë PP/I.nr.134/13, të datës 23.08.2016, ka akuzuar A. G., L. G. dhe L. G. që të tre nga fshati J., Komuna e Gjakovës, me çka si bashkëkryes kanë kryer veprën penale: shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i akuzuari L. G., për veprën penale : mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor fillestar të mbajtur me 26.01.2017, në prani të Prokurorit të shtetit Ali Uka dhe të akuzuarve A. G., L. G. dhe L. G., të njëjtëve ju lexohet aktakuza, ku kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe gjykata është e bindur së të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën. Të akuzuarve iu është dhënë mundësia që të deklarohen lidhur me pranimin ose mospranimin fajësisë.

Më këtë rast, gjykata i ka udhëzuar të akuzuarit për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPRK-së, kështu që pas konsultimeve të bëra të akuzuarit :

A. G., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe deklaroi se ndihet fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

L. G., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe deklaroi se ndihet fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet.

L. G., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe deklaroi se ndihet fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të të akuzuarve A. G., L. G. dhe L. G., për pranimin fajësisë Prokurori i shtetit Ali Uka, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve meqenëse pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve bazohet edhe në provat të cilat janë të bashkangjitura në aktakuzë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa ndikimin e askujt dhe ka kërkuar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. G. av. N. Th. deklaroi se : e përkrahi në tërësi deklaratën e të mbrojturit tim dhe pohimin e tij lidhur me pranimin e veprës penale ngarkuar sipas nenit 365 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I propozojë gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese duke filluar nga pranimi i veprës penale, pendimit të thellë, paraqitjes në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale, është hera e parë që ka ra në kundërshtim me ligjin, meqenëse është një gamë e madhe e rrethanave lehtësuese ku Kodi Penal në mënyrë taksative nuk i ka përcaktuar atëherë i propozojë gjykatës që sipas bindjes së saj dhe justifikimit të shqiptojë dënim të butë dhe me këtë dënim të arrihet karakteri i përgjithshëm dhe konkret i preventives së veprës penale.

Në vijim, gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, vlerësoj se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe në mbështetje të fakteve të propozuara në aktakuzë, konform nenit 326 të KPRK-së.

Në vijim, gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve A. G., L. G. dhe L. G. dhe propozimin e prokurorit të shtetit, e miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasi që vlerësoj se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që të njëjtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe pranimi i fajësisë është bërë dhe në mbështetje të fakteve të propozuara në aktakuzës siç janë: raporti i oficerit policor A. Zh. me numër 2013-DB-1050 datë 11.07.2013, raporti tjetër i oficerit policor N. A. me numër dhe datë të njëjte, raporti tjetër i Rreshter A. B. me numër dhe datë të njëjte, raporti tjetër i oficerit policor Sh. L. , raporti tjetër i oficerit policor N. Rr. me numër dhe datë të njëjtë, raporti i hetuesit D. L. me numër të njëjtë i datës 11.07.2013, raporti i shpejtë me numër dhe datë të njëjtë, shënimi zyrtar me numër të njëjtë të datës 20.04.2016, lista e dëshmimeve me numër të njëjtë i datës 10.07.2013, si dhe fotoalbumi i vendit të ngjarjes , raporti i ekspertizës

mjeko-ligjore nga eksperti mjeko – ligjor Dr. N. U., për të dëmtuarit M. dhe P. K., ekspertiza balistike nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2013-2897/2013-2282, datës 25.09.2013, janë prova të mjaftueshme që dëshmojnë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Duke pasur parasysh se gjykata e ka aprovuar pranimin fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par.4 të KPPK-së si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk u zbatua procedura e provave, dhe as me fjalën përfundimtare e palëve.

Nga gjendja faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi pa dyshim rrjedh se në veprimet e të akuzuarve A., L. dhe L. G. qëndrojnë të gjitha elementët e veprës penale : shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe për të akuzuarin L. G. të gjitha elementet e veprës penale : mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do të zvogëlonin ose përjashtonin përgjegjësin penale të të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenin 73 par. 1, 2, 3 dhe 5 të KPRK-së.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin A. G., gjykata mori gjendjen e dobët ekonomike, i njëjti merret me bujqësi, është mbajtës i familjes, se me të dëmtuarit janë kumar dhe fqinjë dhe se pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale, pranim që sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij si dhe nuk ka qenë i dënuar më parë me ligj, duke i vlerësuar këto rrethana lehtësuese konform nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimit me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin L. G., gjykata mori gjendjen e dobët ekonomike, po ashtu i njëjti merret me bujqësi, i papunë, se me të dëmtuarit janë kumar dhe fqinjë dhe se pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale, pranim që sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij si dhe nuk ka qenë i dënuar më parë me ligj, duke i vlerësuar këto rrethana lehtësuese konform nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimit me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin L. G., gjykata mori gjendjen e dobët ekonomike, i njëjti është student i fakultetit juridik, se me të dëmtuarit janë kumar dhe fqinjë dhe se pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale, pranim që sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij si dhe nuk ka qenë i dënuar më parë me ligj, duke i

vlerësuar këto rrethana lehtësuese konform nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimit me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë.

Gjykata po ashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të dënuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, dhe ky dënim do të ketë efekt preventivë gjeneral për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par.1 lidhur me nenin 31 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.106/16, datë 30.01.2017

Sekretarja juridike,

Arbënore Basha

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Palët kanë të drejtë në Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit të Kosovës e përmes kësaj Gjykate.